

# STATISTIKAT E PESHKIMIT

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	6
5. Periudha e referencës .....	6
6. Mandati institucional.....	6
7. Konfidencialiteti .....	6
8. Politika e botimit.....	7
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	7
11. Manaxhimi i cilësisë .....	8
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor .....	11
19. Komente.....	12
Aneks .....	12

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
1.3. Personi i kontaktit	Rustem Ndroqi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:rndroqi@instat.gov.al">rndroqi@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	23.06.2022
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	23.06.2022
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	23.06.2022
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Të dhënat e peshkimit grumbullohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke u mbështetur në metodikën e GFCM (General Fisheries Commission for the Mediterranean) për grumbullimin e të dhënave bazuar në segmentet e flotës së peshkimit, grumbullimin e logbook-eve nga anijet, intervistat me operatorët e akuakulturës etj.</p> <p>Të dhënat për zënien e peshkut grumbullohen sipas kategorive ujore, specieve dhe në nivel vendi.</p> <p>Statistikat e prodhimit të akuakulturës përmbajnë katër grupe të ndryshme të të dhënave sic përcaktohet në Rregulloren (EC) nr 762/2008 mbi “Statistikat e Akuakulturës”:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi vjetor nga akuakultura (Vëllimi dhe vlera, me përjashtim të prodhimit të rasateve) sipas specieve.</li> <li>• Prodhimi i vezëve të peshkut për konsum njerëzor sipas llojeve, metoda e kultivimit dhe mjedisi ujor.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Input-et e përdorura në akuakulturë, sipas specieve.</li> <li>• Prodhimi i rasateve për rritje të mëtejshme ose lëshim në natyrë sipas specieve.</li> </ul> <p>Vëllimi i prodhimit matet në tonë të peshës së gjallë dhe vlerës ekonomike si çmim i njësisë në monedhën kombëtare për ton, me përjashtim të rasateve të peshkut të cilat maten në numër.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Variablat e mëposhtëm janë regjistruar në lidhje me prodhimin e akuakulturës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Specie” do të thotë speciet e organizmave ujorë të identifikuar duke përdorur kodin ndërkombëtar 3-alfa siç përcaktohet nga FAO (Lista e Specieve ASFIS për Qëllimet e Statistikave të Peshkimit). Speciet individuale grupohen në agregate sipas taksonomisë dhe zakoneve të tyre të jetesës. Këto agregate specifikohen në Klasifikimin Statistikor Standard Ndërkombëtar të Kafshëve dhe Bimëve Ujore (ISSCAAP) dhe të treguara në listën ASFIS.</li> <li>• “Zonat kryesore të FAO” do të thotë zonat gjeografike siç përcaktohet nga FAO (Manuali i standardeve statistikore të peshkimit CWP). Zonat kryesore të FAO-s të mbuluara janë: 37 'Mesdhe dhe Deti i Zi.</li> <li>• “Ambienti ujor” dallon llojet e ujit, ujëra të ëmbël dhe ujëra të kripura.</li> </ul> <p>Metodat dhe llojet e ujit përcaktohen në Shtojcën I të Rregullores (KE) Nr. 762/2008.</p> <p>Kodifikimi i përshkrimit të aktivitetit bëhet duke u bazuar në nomenklaturën e aktiviteteve ekonomike (NVE rev.2).</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Informacioni statistikor mblidhet nga subjektet e peshkimit dhe akuakulturës që operojnë në aktivitetet e mëposhtme:</p> <p>Seksioni A - Bujqësia, pyjet dhe peshkimi</p> <p>Grupi: 03.11 - Peshkimi detar  03.12 - Peshkimi në ujra të ëmbla  03.21 - Akuakultura detare  03.22 - Akuakultura në ujra të ëmbla</p> <p>Prodhimi nga akuakultura destinuar për konsum njerëzor (të gjitha përdorimet për bimët ujore).</p> <p>Ky informacion mbulon të dhëna mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zënien e peshku sipas kategorive ujore;</li> <li>2. Flotat Detare sipas llojit të anijes;</li> <li>3. Flotat detare sipas porteve;</li> <li>4. Zëniet sipas specieve në kategorinë ujrat e brendshme;</li> <li>5. Zëniet sipas specieve në kategoritë detare, bregdetare dhe laguna.</li> </ol>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Peshkimi</b> - Të dhënat zënie peshku (prodhim peshku dhe akuakultura) grumbullohen sipas kategorive ujore.</p> <p><i>Kategoritë ujore të peshkimit janë:</i> peshkimi detar, bregdet, laguna, ujëra të brendshme, akuakulturë dhe molusqe.</p> <p><i>Peshkimi detar:</i> Përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës së peshkimit</p>

dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit.

**Kapaciteti i peshkimit** - Është sasia e peshkut që mund të merret nga një njësi peshkimi.

**Zënie peshku** - Të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustance, molusqe etj), specieve të ujërave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë).

**Akuakultura** - Është rritja e peshkut në kushte artificiale, në të cilin përfshihen: rritje peshku me anë të rasateve, molusqe dhe krustance.

**Flota** - Është numri total i anijeve të peshkimit që shfrytëzon një burim të caktuar. Flota vepron pothuajse plotësisht në Nën-Zonën Gjeografike (NZGJ) 18 (Adriatiku i Jugut).

Flota detare shqiptare nisur nga qëllimi i anijes ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi:

**Me tërheqje (fundore dhe pelagjike)** - metoda e peshkimit më e rëndësishme dhe një nga më efikasat në botë është ajo me tërheqje. Kjo metodë kryhet si në ujëra të cekëta dhe deri në thellësi 2000 m. Rrjetat tërheqëse përdoren për peshkim fundor dhe pelagjik, në varësi të formës së rrjetës të përdorur. Prosesi i tërheqjes kryhet për një periudhë të caktuar kohe dhe për një distancë të caktuar, deri në tërheqjen e rrjetës lart dhe zbrazjen e saj. Ky mjet peshkimi përdoret kryesisht për të peshkuar peshqit fundorë.

**Me mrezha** - Këto anije përdorin rrjeta rrethuese dhe detare dhe përbëjnë një grup të madh të të gjitha madhësive, duke filluar nga anije të hapura, zakonisht të paktën 10 m në gjatësi, deri tek anijet që shkojnë në oqean. Këto zakonisht përdoren për të kapur speciet pelagjike të grumbulluara.

**Me koshilok** - Përbëjnë një grup anijesh duke përfshirë mjete me të gjitha madhësitë, duke filluar nga varka të vogla deri tek anijet që peshkojnë në oqean. Koshilokët janë mjetet më të rëndësishme dhe më efektive për të zënë specie që grumbullohen pranë sipërfaqes. Mjeti rrethon tufën në anë të rrjetës, më pas pjesa e poshtme e saj mbyllet (nën tufë) me anë të një litari, i cili nisët nga anija, kalon përmes unazave në fund të rrjetës dhe përsëri në anije.

**Me draga hidraulike** - Dragat janë mjete që gërryejnë fundin e detit për molusqe bivalvë. Dragat përbëhen nga një konstrukt metalik në të cilin kapet thesi i ndërtuar nga unaza metalike ose rrjetë. Dragat mund të tërhiqen me anije ose me krahë. Dragat janë mjete që përdoren në bregdetin e afërt dhe peshkojnë duke qenë në kontakt të fortë me tabanin.

**Me njica** - Madhësia e anijeve ndryshon në lidhje me zonën e gjuetisë. Këto mjete mund të jenë nga varka të vogla për ujërat e brendshme dhe në bregdet, anije të vogla në kuvertë në ujërat bregdetare dhe anije të mesme që peshkojnë në det të hapur. Në ujërat bregdetare është shumë e zakonshme që kjo formë peshkimi të përdoret si një metodë sekondare sipas sezonit të peshkimit dhe specieve target.

**Anije shumëpërdorimshe** - mjete peshkimi të cilat përdorin në menyrë të alternuar dy ose më shumë vegla peshkimi pa modifikime të mëdha në anije.

3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e Statistikave të Peshkimit janë: Subjektet e peshkimit dhe Akuakulturës.
3.6. Popullata statistikore	<p>Të gjitha objektet e prodhimit komercial aktiv të kafshëve ose bimëve ujore. Popullata statistikore i referohet numrit të zënieve të peshkut sipas kategorive ujore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Detar</li> <li>2. Bregdetar</li> <li>3. Laguna</li> <li>4. Ujërat e brendshme</li> </ol> <p>II. Akuakultura</p> <p>III. Molusqe</p> <p>Dhe zëniet sipas specieve kryesore dhe kategorive ujore: Speciet Detare, Bregdetare, Lagunë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Açuga</li> <li>• Karkalec i thellësisë</li> <li>• Merluc</li> <li>• Sardele</li> <li>• Barbun</li> <li>• Skampi</li> <li>• Oktapod</li> <li>• Kallamar</li> <li>• Stavrid</li> <li>• Ton</li> <li>• Specie të tjera</li> </ul> <p>Speciet e Ujërave të brendshme</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krap</li> <li>• Skortë</li> <li>• Karas</li> <li>• Ballgjer i bardhë</li> <li>• Qefull</li> <li>• Perka ose Sharmak</li> <li>• Specie të tjera</li> </ul>
3.7. Zona e referencës	Statistikat e Peshkimit mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat statistikore për zënien e peshkut sipas kategorive të ujit dhe akuakulturës datojnë në vitin 1990, ndërsa zënia e peshkut sipas llojeve dhe flotës së peshkimit daton në vitin 2014.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.

4. Njësia matëse	<p>Në statistikat e Peshkimit njësia matëse e përdorur është:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Tonë për statistikat e zënieve,</li> <li>2. Numër për statistikat e rasateve dhe flotës detare.</li> </ol>
5. Periudha e referencës	<p>Periudha e referencës për Statistikat e Peshkimit është viti kalendarik 1 Janar - 31 Dhjetor 2021. Ky raport i referohet vitit 2021.</p>
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e statistikave të Peshkimit konsiston në: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021</a></li> <li>• <a href="#">Ligji Nr. 64/2012 "Për Peshkimin"</a></li> </ul> </li> <li>➤ Baza ligjore përkatëse në nivel Evropian konsiston në: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Rregullorja (EC) Nr.216/2009. 216/2009</a> mbi “Statistikat e Zënieve të Peshkut, për peshkimin në zona të caktuara përveç Atlantikut të Veriut”</li> <li>• <a href="#">Rregullorja (EC) nr 762/2008</a> mbi “Statistikat e Akuakulturës”.</li> </ul> </li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Statistikat e Peshkimit transmetohen në EUROSTAT nëpërmjet platformës eDAMIS. Transmetimi i të dhënave për zëniet vjetore dhe sipas specieve kryhet një herë në vit në DCRF dhe GFCM.</p>
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon</p>

	<p>paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësive statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendarin</a> e publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin e përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <a href="#">Njoftimi për shtyp</a>;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Seksioni <a href="#">Kërkesa të dhënash</a>.</li> </ol>
<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	Statistikave e Peshkimit publikohen në baza vjetore.
<b>10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Njoftim për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë si: akuakultura, flota etj. Formatin e njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos dhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp për Statistikat e Peshkimit publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT në temën: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">"Peshkimi"</a></li> <li>• <a href="#">"Shqipëria në Shifra"</a></li> </ul>

10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: <a href="#">Databaza Statistikore</a>
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat mbi Statistikat e Peshkimit janë të dhëna administrative dhe si të tilla niveli më i detajuar i të dhënave që merren është në nivel vendi. Pra, INSTAT nuk disponon të dhëna në nivel mikro për Statistikat e Peshkimit.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> mbi Statistikat e Peshkimit.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit dokumenton gjithë të procesin e punës dhe procedurat mbi Statistikat e Peshkimit për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Është bërë një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha. Në rast ndryshimesh, të dhënat administrative përdoren për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen ndryshime të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e Statistikave të Peshkimit ndahen në përdorues të brendshëm dhe të përdorues të jashtëm: ➤ Përdorues të jashtëm



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione të administratës publike</li> <li>• Universitetet</li> <li>• Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare</li> <li>• Bizneset</li> <li>• Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme.</li> </ul> <p>➤ Përdorues të brendshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare</li> <li>• Drejtoria e Statistikave Ekonomike</li> <li>• Drejtoria e Statistikave Sociale</li> <li>• Drejtoria e Sektorit Real</li> </ul> <p>Të cilët përdorin statistikat e peshkimit si input në punën e tyre.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me Statistikat e Peshkimit për vitin 2021 janë rreth 2.740 klikime.</p> <p>Gjatë 2021 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e “Statistikave të Peshkimit” është vlerësuar me 3,45 (69%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave për statistikat e Peshkimit për vitin 2021 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura. Shkalla e Plotshmërisë të të dhënave të në lidhje me Statistikat e Peshkimit për 2021 është 100%.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton MBZHR për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të bëra në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet sepse të dhënat bazohen në burime administrative.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për përditësimet e mundshme në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jo kampionimit trajtohen bazuar në politikën e trajtimit të gabimeve.</p>
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>	
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet për Statistikat e Peshkimit janë publikuar në faqen e internetit të</p>

	<p>INSTAT 174 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 174 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Peshkimit është 31 Dhjetori 2021.</p> <table border="1" data-bbox="435 226 903 353"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>6/23/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>174</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e publikimit	6/23/2022	Afatet kohore	174		
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e publikimit	6/23/2022								
Afatet kohore	174								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat për Statistikat e Peshkimit, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të Peshkimit ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="435 528 903 701"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>6/23/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>6/23/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e shpallur	6/23/2022	Data e publikimit	6/23/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e shpallur	6/23/2022								
Data e publikimit	6/23/2022								
Vonesa në kohë	0								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Statistikat e Peshkimit janë gjithë përfshirëse; ato prodhohen vetëm në nivelin kombëtar.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Të dhënat mbi Zënien e peshkut sipas llojeve dhe flotës së peshkimit datojnë që nga viti 2014 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 8 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=8).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Llogaritë Kombëtare marrin të dhënat në lidhje me Llogaritë Ekonomike të Peshkimit në baza tremujore nga Sektori i Blegtorisë dhe Peshkimit.								
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet përpara se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu marrëdhëniet midis variablave dhe koherencës në seri të ndryshme.								
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të Peshkimit pranë sektorit të Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit është: 2 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT, pasi të dhënat e statistikave të peshkimit sigurohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.								
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>									
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>								

17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Peshkimit do të raportojnë ndryshime, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave të peshkimit për vitin 2021, subjekt i këtij raporti.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Për Statistikat e Peshkimit, INSTAT përdor informacionin e siguruar nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</li> </ul>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Statistikave të Peshkimit janë mbledhur në bazë tremujore dhe vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të Peshkimit për vitin 2021, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi.</p> <p>Të dhënat për Statistikat e Peshkimit janë të dhëna me burim administrativ. Mbledhja e të dhënave sipas standardeve të BE mundëson analizimin dhe zhvillimin e politikave për menaxhimin e aktivitetit të peshkimit në det.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrole logjike dhe matematike. Këto kontrole kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Mbledhja e të dhënave sipas standardeve të BE-së mundëson analizimin dhe zhvillimin e politikave për menaxhimin e veprimtarisë së peshkimit në det. Informacioni në lidhje me potencialin e flotës së peshkimit të një vendi rrjedh nga të dhënat vjetore të zënies dhe përbërja e flotës. Për sa i përket të dhënave për zëniet, nga viti 2012, me hyrjen në fuqi të Ligjit 64 "Për Peshkimin", të gjitha anijeve me gjatësi mbi 10 metra, u kërkohet të dorëzojnë librat e regjistrave të plotësuar në pëputhje të plotë me informacionin e kërkuar në Inspektoratin e Peshkimit.</p> <p>Një nga metodologjitë e propozuara nga ekspertët e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është rindërtimi i zënieve duke përdorur si bazë përpjekjen aktuale të peshkimit.</p> <p>Kjo metodologji konsiston në hapat e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përzgjedhja e viteve kur besohet se të dhënat për zëniet janë më të sakta dhe të besueshme.</li> <li>2. Vlerësimi i përpjekjeve të peshkimit (tonë / vit) për secilën anije peshkimi</li> </ol>

	<p>sipas segmentit të flotës, për vitet e zgjedhura</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>3. Vlerësimi i përpjekjes mesatare për vitet e zgjedhura</li> <li>4. Informacion mbi flotën kombëtare për periudhën para vitit 2012 (numri i përgjithshëm i anijeve të peshkimit dhe sipas segmentit të flotës)</li> <li>5. Shumëzoni përpjekjet e llogaritura sipas segmenteve të flotës me numrin e anijeve të peshkimit në vit</li> <li>6. Me këtë shumëzim zëniet do të llogariten për vitet para 2012</li> <li>7. Një procedurë e ngjashme do të përdoret për të llogaritur zëniet sipas specieve, duke marrë parasysh proporcionet, përqindjen që zë secila specie në zëniet totale vjetore për periudhën e zgjedhur (Kjo procedurë do të kryhet vetëm për speciet kryesore tregtare të specifikuara në DCRF dhe të rëndësishme në vendin tonë)</li> <li>8. Kjo procedurë do të kryhet vetëm për speciet kryesore tregtare të specifikuara në DCRF dhe të rëndësishme në vendin tonë.</li> <li>9. Kjo qasje mund të jetë e vështirë për t'u zbatuar, për shkak të mungesës së informacionit të saktë mbi flotën kombëtare para vitit 2010 (para këtij viti softueri Kombëtar i Regjistrimit të Flotës nuk ishte në përdorim).</li> </ol> <p>Informacioni mbi zëniet totale dhe sipas specieve për vendet e Mesdheut është në dispozicion në bazën e të dhënave GFCM.</p> <p>Ky informacion mund të përdoret për të rindërtuar zëniet sipas specieve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Së pari vlerësohet përqindja e zënë nga një specie, në gjithsej zënie (për atë specie) të shteteve të tjera të Adriatikut, duke marrë parasysh periudhën 2012-2018</li> <li>2. Përqindja e marrë do të shumëzohet me zëniet totale për ato specie të vendeve të tjera të Adriatikut</li> <li>3. Rezultati do të jetë zënia e flotës kombëtare për speciet e zgjedhura</li> <li>4. Kjo procedurë do të ndiqet gjithashtu për rindërtimin e zënive të specieve të tjera komerciale të specifikuara në DCRF dhe të rëndësishme në vendin tonë.</li> </ol>
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentet	
<b>Aneks</b>	